Kronikë

Dibër/ I vuri eksploziv në lokal dhe shtëpi 54-vjeçarit, në pranga Etmond Lalaj! Kishte fshehur edhe arsenal armësh brenda në mur (EMRAT)

Etmond Lalaj është arrestuar nga policia e Dibrës, pasi i ka vendosur lëndë eksplosive në afërsi të banesës dhe dyqanit një 54-vjeçari. 42-vjeçarit iu gjet edhe një arsenal armësh, të cilin e kishte fshehur brenda në mur dhe i kishte mbuluar me një panoramë lecke

Redaksia
4 Janar, 11:08 | **Përditesimi: 4 Janar, 14:32**

Share

DIBËR- Etmond Lalaj është arrestuar nga policia e Dibrës, pasi i ka vendosur lëndë eksplosive në afërsi të banesës dhe dyqanit një 54-vjeçari.

42-vjeçari, banues në Burrel, i dënuar me parë për disa vepra penale në fushën e krimeve ndaj personit dhe pasurisë, dhe aktualisht vuante dënimin alternativ 'Shërbim prove', për shkak të një konflikti me Artan Cukën, ka shkuar pranë banesës së këtij të fundit, ku ka vendosur dhe ka shpërthyer një sasi e vogël lëndë plasëse eksploziv pa shkaktuar dëme.

Gjithashtu, në portën hyrëse të dyqanit të Artan Cuka ka vendosur një tjetër sasi lëndë plasëse eksploziv, dhe nga shpërthimi janë shkaktuar dëme të vogla materiale.

LEXO EDHE:
Frymëzuese/ Njihuni me 70 vjeçarin tornitor në Bulqizë që nuk e ndal punën: E kam pasion! Do ta vazhdoj sepse e bëj me qejf

Në cilësinë e provës materiale, Etmond Lalajt, iu gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pushkë, 87 copë fishek, 4 granata dore, 5 copë ndezëse granatash, 4 metër fitil zjarrpërcjellës, 2 targa të një automjeti në pronësi të një shtetasi tjetër dhe një aparat celular. 42-vjeçari i kishte fshehur armët brenda në mur dhe i kishte mbuluar me një panoramë lecke.

Sipas policisë 42-vjeçari dyshohet se është autor dhe i disa ngjarjeve të mëparshme me eksploziv në Burrel, për të cilin në bashkëpunim me prokurorinë vijojnë hetimet intensive për zbardhjen dhe grumbullimin e provave, si dhe identifikimin e kapjen e bashkautorëve të tjerë të përfshirë në këto ngjarje.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: etmond lalaj | bulqizë | Dibër | artan cuka

Komento

Komente

Shefi: 05/01/2024 08:13

Tipa te tille duhet ti heqesh qafe para se te arrijn te bejne krime te renda

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si do të jetë politika këtë vit?

Bashkëpunuese | Konfliktuale | Nuk e di

Lajme të tjera

Dibër, u rrëzua nga skela ku po punonte, plagoset 38 vjeçari! Niset me urgjencë drejt spitalit të Traumës në Tiranë
30 Dhjetor 2023, 16:26

Tenderi 3 mln euro, 3 vite burg për ish-kryebashkiakun e Bulqizës, Lefter Alla! 2 vite për të afërmin fitues, Aqif Konesha! 6 lirohen me kusht
28 Dhjetor 2023, 10:13

Dibër/ Shkoi për piknik me tre shokët e tij, 19-vjeçari bie nga shkëmbi
27 Dhjetor 2023, 19:14

Hapet tuneli i Murrizit, përfundojnë gërmimet pas 55 muajsh! Në vitin 2024 pritet të nisë qarkullimi! Rama: Shenjë e mirë që u hap para se të mbarojë viti

Eliza Gjediku

26 Dhjetor 2023, 14:34

Plagoset 36 vjeçari gjatë punës në minierën e Bulqizës, transportohet me helikopter drejt spitalit të Traumës në Tiranë (EMRI)
25 Dhjetor 2023, 15:13

Mat/ Sherr për motive pronësie, 46-vjeçari qëllon me sende të forta bashkëfshatarin, vihet në pranga
25 Dhjetor 2023, 10:11

EMRI/ Merrte makina me qira në Tiranë, u kopjonte çelësin dhe pas disa kohësh i vidhte, pranga 42-vjeçarit! I shiste në servisin e tij në Dibër

Sokol Dema

25 Dhjetor 2023, 10:00

10 mijë lekë ryshfet për të lëshuar vërtetime false për pajisje me dokumente bullgare, lihet në burg vëllai i kryebashkiakes së Bulqizës dhe një tjetër zyrtar
24 Dhjetor 2023, 12:18

Dibër, tentuan të kontrabandonin bagëti nga Maqedonia e Veriut për t'i shitur në vendin tonë, arrestohen babë e bir në pikën kufitare të Bllatës
22 Dhjetor 2023, 15:43

Dhanë vërtetime false deri në 100 mijë lekë që qytetarët të përfitonin pasaporta bullgare, pranga 3 punonjësve të njësisë Ostren dhe bashkisë Bulqizë (EMRAT)
21 Dhjetor 2023, 12:36

I dha të afërmit tenderin 3 mln euro, ish-kryebashkiaku i Bulqizës, Lefter Alla kërkon pafajësi në GJKKO: Lashë biznesin për ti shërbyer qytetarëve
21 Dhjetor 2023, 12:07

Dibër/ Aksident i trefishtë në aksin Peshkopi-Maqellarë, 2 të plagosur
17 Dhjetor 2023, 17:30

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje